



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 3144 / Prot.
11

Patos, më 27 / 11 / 2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 27 NËNTOR 2025

Vendi: Njësia administrative Ruzhdie

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjuesë publike me temë: “Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë të GMS dhe përfaqësues të bashkisë Patos, banorë, kryetarë të fshatrave etj.

Në total 19 pjesëmarrës

Takimin hapet nga sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit



Sekretare e Këshillit

znj. Refaela Xeba

Dëgjese publike me temë:

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”, jemi këtu sot për të prezantuar para jush dokumentin përfundimtar lidhur mbi buxhetin 2026 dhe PBA 2026-2028. Ftoj ekzekutivin të prezantoj materialin dhe sipas rregullave mund të drejtoni pyetjet, rekomandimet dhe sugjerimet tuaja.

Zv/ Kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- Përhëndetje! Ju falenderoj që jeni bashkuar sot me ne për dëgjesën përfundimtare të buxhetit 2026 dhe PBA-së 2026-2028. Ftoj drejtoreshën e financës për të prezantuar materialin se çfarë është parashikuar për vitin 2026 për njësinë tuaj.



Zv/ Kryetare e bashkisë Patos

znj. Ina Sauli

Dëgjese publike me temë:

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

Drejtoreshë e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari- Përhëndetje! Pas gjithë takimeve dhe dëgjesave publike që kemi bërë jemi në fazën finale duke marrë kërkesat tuaja parasysh. Në buxhetin e 2026 kemi një rritje të të ardhurave dhe 25 % e tyre janë adresuar për investim në tre njësitë administrative. Këto investime përfshin rrugë, banesa sociale, ndriçim rrugor, rrugë parcelash etj.



**Drejtoresh e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari
Dëgjese publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

Drejtoresh e Urbanistikës dhe Planifikimit Urban, znj. Boreta Murati- Përsëndetje!Për sa



**Drejtoresh e Urbanistikës dhe
Planifikimit Urban
znj. Boreta Murati
Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

i përket ndërhyrjeve të parashikuara në njësinë Ruzhdie, një bashkëfinancim kemi me banesat sociale në fshatin Siqec, Drenie, Ruzhdie. Gjithashtu kemi rrugët e përfshira në marrëveshjen Kuadër ku ne kemi filluar paraprakisht me shtrimin e disa prej rrugëve, por duke qënë se ne nuk i arrijmë dot të gjitha rrugët njëherësh kemi filluar pak nga pak. Në zonën e Ruzhdies ne kemi filluar me rrgën Ymeraj ku aktualisht po ndërtohen muret mbajtës. Ne kemi filluar me ASHP duke ndërtuar në disa segmente dhe do të vazhdojmë. Brenda muajit dhjetor mendojmë që të përfundoj ndërtimi i rrugës me asfalto beton në Ymeraj. Rrugët e parcelave në çdo fshat po vazhdohet me hapjen e tyre. Rrethimet e varrezave do të vazhdojnë edhe në vitin në vijim 2026. Një nga investimet më të mëdha për Ruzhdi është shtrimi i rrugës Manxharaj që fillon nga shkolla Gjynoqarë. Në planin e PBA-së ne kemi edhe shtrimin e rrugës Kararaj në njësinë Ruzhdie. Përveç rikonstruksionit të banesave sociale që po bëhet me bashkëfinancim nga Ministria, kemi edhe rikonstruksionin e banesave nga ASHP. Ne do të vazhdojmë edhe vitin e ardhshëm bazuar në kërkesat e ardhura në bashki për këto banesa. Edhe ndriçimi do vazhdoj me ndërhyrje në të gjitha segmentet pa ndriçim. Për sa i përket rrugëve që janë në marrëveshjen Kuadër janë rruga Myftaraj, Xhoraj, Malaj.

Drejtor i ASHP, z. Enco Xhaferaj – Përsëndetje! Lidhur me rrugët bujqësore ne po punojmë dhe aktualisht jemi në njësinë Ruzhdie. Në Gjynoqarë dhe Kasnicë kemi përfunduar

një pjesë të madhe dhe do vazhdojmë më Ruzhdien tani. Do punojmë deri sa të mbarojmë



**Drejtor i ASHP
z. Enco Xhaferaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

rrugët kryesore edhe pse kjo ka kosto shumë të madhe. Lidhur me ndriçimin kemi ndërhyrë në disa lagje në 2025, kanë ngelur edhe disa lagje të tjera. Do të mundohemi që me panel diellor ta mbarojmë në 2026. Për pjesën e rrugëve me çakull kemi planifikuar për ndërhyrje në 2026. Për pastrimin e kanaleve kemi planifikuar ndërhyrje gjatë gjithë vitit, kemi sjell edhe tubo kur është kërkuar. Tumbinot janë për tu vendosur dhe janë planifikuar për tu vendosur në Gjynoqar, Kasnic, Siqec. Për pastrimin dhe buldozerit ne e sollëm në Ruzhdie për hapjen e rrugëve, por moti nuk ka mbajtur. Sapo të hapet moti do punojmë në njësinë tuaj. Për pastrimin do e fusim në Siqec, por edhe ju do të duhet të paguani taksën lidhur me pastrimin.

Banor i Ruzhdie, z. Rexhep Myftari- Unë kam tokën dhe nuk kam marrë shërbim nga



**Banor i Ruzhdie
z. Rexhep Myftari**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

traktori i bashkisë për hapjen e rrugës ndaj kërkoj ndërhyrje.

Administrator i njësisë administrative Ruzhdie, z. Agim Mesutaj- Përshëndetje! Unë do



**Administrator i njësisë administrative
Ruzhdie
z. Agim Mesutaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin
2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

doja të shtoja një sugjerim. Nëse është e mundur te shtohet në buxhet edhe rëra bituminoze për rrugët. Terreni është i madhe dhe nuk vishet dot i gjithë me asfalto beton, çakulli nuk mban. Problematikat këtu kanë të bëjnë me rrugët e arave që kemi filluar po punojmë. Në Kasnic kemi filluar me rrugët e parcelave dhe Gjynoqarë po mbarojnë. Të gjitha banorët kërkojnë rrugë edhe pse në hartë nuk ka rrugë dhe ne e kemi zgjidhur me mirëkuptim me banorët për hapje rruge. Kërkoj që të shtohet edhe çakulli sepse kemi shumë rrugë që kanë nevoj për karikim.

Drejtor i ASHP, z. Eneo Xhaferaj- Do të vazhdojmë me vazhdohet me hapjen e rrugëve



**Drejtor i ASHP
z. Eneo Xhaferaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

dhe do mundohemi të shtojmë edhe makinat me çakull për njësinë tuaj.

Zv/ Kryetare e bashkisë, znj. Ina Sauli- Nëse nuk keni pyetje të tjera e deklarojmë të mbyllur këtë dëgjesë publike. Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!



**Zv/ Kryetare e bashkisë
znj. Ina Sauli**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj